

Në bazë të nenit 26 të Ligjit të mbrojtjes nga zjarri ("Gazeta zyrtare e Kosovës"), Bordi i Drejtorëve i Kompanis Regjionale Ujësjell Hidrosistemi "RADONIQI" Gjakova-Rahovec, në Gjakovë, me _____, miratoi :

R R E G U L L O R E N E M B R O J T J E S N G A Z J A R R I

I. D I S P O Z I T A T E P Ë R G J I T H S H M E

Neni 1.

Me këtë rregullore, në pajtim me Ligjin, caktohen masat për mbrojtjen nga zjarri, organizimi dhe aftësimi i punëtorve për mbrojtjen nga zjarri, mjetet teknike dhe tjera për fikjen e zjarrit, detyrat dhe përgjegjësit e Bordit, stafit menagjues dhe punëtorve të tjerë në zbatimin e mbrojtjes nga zjarri, veprimi në rastë zjarri në objektet e K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI" SH.A.në Gjakovë.

Neni 2.

Qeshtjet, të cilat nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, zbatohen dispozitat ligjore dhe dispozitat e organeve kompetente.

Neni 3.

Mbrojtja nga zjarri zbatohet me aktivitete të punëtorëve të K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI"SH.A. në Gjakovë.

Mbrojtja nga zjarri, përfshin tërësin e rregullave dhe veprimeve të natyres organizative, teknike dhe arsimore, të cilat ndërmerren me qëllim të pengimit, zbulimit, fikjes së zjarrit si dhe shpetimin e njerëzve dhe të mirave materjale.

II. M A S A T P Ë R M B R O J T J E N G A Z J A R R I

Neni 4.

Me qëllim të mbrojtjes nga zjarri, largimit të mundësive të shkaktimit dhe pengimit dhe zgjerimit të tij, zbatohen masat për mbrojtje nga zjarri.

Neni 5.

Punëtori në zbatimin e masave për mbrojtjen nga zjarri, gjatë kryerjeve të punëve dhe detyrave të veta të punës, realizon të drejten dhe obligimin nga mbrojtja nga zjarri.

Neni 6.

Çdo punëtor e siguron mbrojtjen nga zjarri gjatë kryerjeve të punëve dhe detyrave të veta të punës, në mënyrë dhe procedure të caktuar me Ligj, me këtë Rregullore dhe në bazë të vlersimit të vetë në rast konkret.

Neni 7.

Me këtë rregullore caktohen masat e përgjithshme dhe të veçanta të mbrojtjes nga zjarri.

Masat e përgjithshme të mbrojtjes nga zjarri caktohen sipas rregullit për gjitha punët dhe detyrat e punës ku egziston rreziku i përgjithshëm nga zjarri. Masat e posaqme caktohen për llojet e posaqme të punëve, të cilat mbrojtja nga zjarri sigurohet me udhëzime të posaqme për punë.

Neni 8.

Në K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI"SH.A. në Gjakovë, ndërmerren masat e mbrojtjes nga zjarri siq vijon:

- Gjatë projektimit dhe kryerjeve të punëve, adoptimit dhe rekonstruktimit në objektet egzistuese, projektimit dhe ndërtimit të objekteve të reja, montimi i paisjeve dhe mjeteve në ato objekte, zbatohet Ligji, masat normative teknike dhe standardet e mbrojtjes nga zjarri .
- Objektet duhet me qenë të paisuara me hidrante, aparata dhe paisje dhe mjete për fikjen e zjarrit. Numri, lloji dhe lokacioni të këtyre mjeteve caktohet me Planin e mbrojtjes nga zjarri, normat teknike dhe standardet e mbrojtjes nga zjarri
- Elektrikë, ventilimit, nxetësisë, rryfepritsit dhe instalimet tjera dhe paisjet në objekte, duhet të kryhen rrespektivisht të vendosen ashtu që mos të paraqesin rrezik për shpërthimin e zjarrit.

Punëtorët, kan për detyrë mbikqyrjen dhe mirëmbajrjen e instalimeve dhe paisjeve të lartëcekura nga paragrafi i lartëcekur, janë të obliguar të bëjnë kontrollen e rregullsisë dhe të funksionimit të drejtë të paisjeve dhe instalimeve, ashtu që në rastë të dëmtimit mos të shkaktojnë zjarrë.

Për funksionimin e rregullt të instalimeve dhe paisjeve përgjegjës është udhëheqësi i Njësis punuese në rrethin në të cilin kryhen detyrat dhe punët e mirëmbajtjes të instalimeve dhe paisjeve.

- Në objekte të caktuara, të cilat mbahen dhe përdoren gazra djegëse, lëngjet djegëse dhe materje tjera djegëse ose formojnë përzierje eksplozive, e këto janë: Stacioni i filtrimit, Trafostacioni 35/6 KW Sopot –fuqi 4 MW, Stacioni i pompave Janosh,

Stacioni i pompave Rahovec, Depoja në Lug Bunar, objektet përrreth pendes dhe Ndërtesa e administrates në Gjakovë, NJ, P, në Rahovec dhe NJP. në Prizren është e ndaluar pierja e duhanit, përdorimi i flakes së haptë, ndriqesve me flake dhe mjeteve për ndezje, përdorimi i mjeteve të cilat gjuajnë xixa, përdorimi i paisjeve nxemse me sipërfaqe të skuqura dhe mbajtjen dhe deponimin e materjeve të cilat kanë veti vetëdjegëse.

- Deponimi dhe ruajtja e bombolave të mbushura me gazra dhe atyre të zbrazta, mund të kryhet vetëm në depon kryesore të parapara për mbajtjen e këtyre materjeve të K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI" në Gjakovë.

- Është e ndaluar larja e makinave dhe paisjeve me lëngje djegëse sa janë duke punuar me to.

- Puna me flake të haptë dhe paisjeve me sipërfaqe të skuqura, aparata për saldim, prerje në vendet në të cilat me rregulla teknike nuk është parapara dhe pa lejen paraprake të punëtorit kompetentë.

Para fillimit të punëve nga paragrafi i më lartëcekur, udhëheqsi i punëve e njofton punëtorin përgjegjes në punët dhe detyrat e mbrojtjes nga zjarri në vendin dhe kohën e kryerjes së atyre punëve, për të cilën do të jep Lejen me shkrim për kryerjen e punëve dhe urdhëron masat të cilat duhen të ndërmerren.

- Materjali i hargjuar, yndyratat, vajrat, ngjyrat e prishura, krpat e lyera me yndyra, pambuku i lyer me yndyra, plastike dhe materjale tjera, ashkla e drurit, copa letrash dhe materjal tjetër mbeturinash, duhet që me kryerjen e orarit të punës të barten nga hapsira punuese dhe të hudhën në vend ku më pare do të cakton punëtori përgjegjes në punët dhe detyrat e mbrojtjes nga zjarri.

Materjet nga paragrafi i mësipërm, gjatë kohës së punës duhet të hudhën në kanta metalike me kapak.

- Mbushja e rezervuareve me lëngje djegse (karburante) mund të kryhet në prezencën e punëtorit përgjegjes në punët dhe detyrat e mbrojtjes nga zjarri.

- Në lokalet e objekteve të K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI" në Gjakovë, nuk lejohet përdorimi i nxemseve elektrike "reshove", kalorifereve, radiatorve elektrik dhe aparateve tjera termo-elektrike për ngrohje, për përdorimin e tyre do të jepet Pëlqim me shkrim nga ana e punëtorit përgjegjes në punët dhe detyrat e mbrojtjes nga zjarri.

- Rugët e afrimit, hyrjet, daljet, kalimet dhe shkallët në objektet dhe për rrethë tyre duhet të jenë gjithmonë të lira për kalim të pa penguar.

Kryerja e punëve të rrezikuara nga zjarri dhe eksplodimi, jashtë objektit-hapsires që për asi lloji pune është parapara, mund të lejohet vetëm me kushte që janë ndërmarr masa përkatëse për sigurimin nga zjarri.

III. ORGANIZIMI DHE KRYERJA E AFTËSIMIT TË PUNËTORVE NGA MBROJTJA NGA ZJARRI

Neni 9.

Aftësimi i punëtorve nga mbrojtja nga zjarri është në interes të përgjithshëm.

Programi i aftësimit të punëtorve nga lamia e mbrojtjes nga zjarri caktohet në bazë të kërkesave të K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI" në Gjakovë.

Neni 10.

K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI" në Gjakovë, i siguron kushtet që çdo punëtor, veçanarisht punëtori i cili punët dhe detyrat e punës i kryen me rrezik të rritur nga zjarri, para se të sistemohet në punë, në mënyr të obligueshme të njohftohen me rreziqet nga zjarri dhe gjatë punës të kujdeset për aftësimin e mëtutjeshëm të tij nga lamia e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 11.

Aftësimi i punëtorve përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike.

Aftësimi bëhet për të gjitha kategorit e punëtorve dhe në të gjitha punët . Programin e aftësimit të punëtorve e bie Menagjerit i Kompanis.

Në pregaditjen e programit ndihmen profesionale ja ofron Organizata e zjarrfikseve

Aftësimin e punëtorve e bënë personi me pregaditje të lartë profesionale nga lamia e mbrojtjes nga zjarri. Evidentimin e aftësimit të punëtorve e udhëheq personi përgjegjes i cili i mbush listat evidentuese që punëtori është i aftësuar nga lamia e mbrojtjes nga zjarri.Mbi aftësimin e punëtorve nga lamia e mbrojtjes nga zjarri mbahet evidenca e caktuar.

Neni 13.

Përbërja e programit për aftësimin e punëtorve nga lamia e mbrojtjes nga zjarri, mvarsisht nga vendi i punës dhe rreziqet e zjarrit përfshijnë, dijenin si vijon:

- mbi rreziqet e përgjithshme dhe të posaqme, të cilat rrezikojnë punëtorët dhe pasurin materjale;
- mbi organizimin e mbrojtjes nga zjarri:
- mbi paisjet dhe mjetet për fikejen e zjarrit:
- mbi përdorimin praktik të aparateve të caktuara për fikejen e zjarrit.

Neni 14.

Pas mbarimit të aftësimit të punëtorve , në K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI" në Gjakovë, kryhet verifikimi i aftësive teorike dhe atij praktik të punëtorve me anë të testeve.

Punëtori, i cili nuk tregon dijeni të duhura, duhet edhe më tej të atësohet.

Neni 15.

Pas kryerjes së aftësimit të punëtorve, mvarsishtë nga punët dhe detyrat e punës, secili punëtor e merrë vërtetimin mbi kryerjen e aftësimit me detyra të qarta të cekura me rastin e shpërthimit të zjarrit dhe atë:

- të lajmërojë zjarrin,
- të fikë zjarrin me doracakët për fikejen e zjarrit dhe pas ardhejes së zjarrfikësve ti bashkangjitet ekipit të cekur,
- të shpëtoi punëtorët dhe pasurin e rrezikuar.

Neni 16.

E drejta e punëtorit në shfrytëzimin e paisjeve të përbashkëta dhe mjeteve për fikjen e zjarrit, bazohet në raste konkrete dhe nevojave konkrete të vërteta për mbrojtje nga zjarri në vendin e caktuar.

Me paisje dhe mjete për fikjen e zjarrit disponojnë punëtorët e punësuar në K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI" në Gjakovë.

IV. PAISJET TEKNIKE DHE MJETET PËR FIKJEN E ZJARRIT

Neni 17.

Me qëllim të fikjes së zjarreve fillestare K.R.U. Hidrosistemi "RADONIQI" Gjakovë, i siguron mjetet doracake dhe transportit për fikejen e zjarrit fillestar, rrjeten e mbrendshme dhe të jashtme të hidrantve, mjetet stabile për fikejen e zjarrit dhe mjetet tjera të parapara me Planin e mbrojtjes nga zjarri.

Neni 18.

Ndërmarrja e cakton numrin e nevojshëm të paisjeve dhe mjeteve për fikjen e zjarrit në pajtim me kushtet specifike dhe madhësin e objekteve.

Paisjet dhe mjetet për fikjen e zjarrit duhet të qëndrojnë në të gjitha vendet ku egziston rreziku nga zjarri.

Hyrjet dhe afrimi te këto mjete duhet të jenë gjithmonë të lira, dhe për këtë do të kujdeset punëtori përgjegjes i Ndërmarrjes.

Neni 20.

Kur punëtoret i përdorin këto paisje duhet menjëher të informojnë punëtorin përgjegjes të mbrojtjes nga zjarri dhe eprorin e drejtëpërdrejtë.

Neni 21.

Kontrollen e rregullshmëris, mirëmbajtjen dhe mbushjen e aparateve për fikejen e zjarrit duhet të bëhet më së paku një here në gjashtë muaj. Kontrollen e rregullshmeris e bënë servisi i autorizuar .

Sejcili aparat për fikjen e zjarrit duhet të ketë shenjen e kontrollit, data e mbushjes të vërtetuar me shkrim dhe me vulë.

Neni 22.

Rrjeten e jashtme dhe të mbrendshme të hidrantve e mirëmban në gjendje të rregulltë shërbimi kompetent për mirëmbajtje. Kontrollen e rregullshmëris të rrjetit të hidrantve dhe rryfepritësve mund ta bëjë organizata e cila është e autorizuar të bëjë këtë veprimtari.

Neni 23.

Zjarri në afërsi të rrjetit elektrik, si dhe zjarret afer paisjeve elektrike të cilat janë nën tension të ulët dhe të lartë nuk është e lejshme të fiken me ujë dhe aparate me shumë për shkak të rrezikut për jetë të punëtorve.

V. ORGANIZIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 24.

Me qëllim të zbaimit të rregullave dhe masave të mbrojtjes nga zjarri, punëve dhe detyrave tjera të rregulluara me ligjin dhe me rregulla tjera nga lamia e mbrojtjes nga zjarri, me këtë Rregullore, në pajtim me ligjin, të vendimeve të organit Kompetent dhe të caktimit të kategorizimit të objekteve të K.R.U. HS."Radoniqi" në kategorit e objekteve:

- * Stacioni i filtrimit, në kategorin e dytë të rrezikshmeris nga zjarri,
- * Trafostacioni 35/6 KW Sopot –fuqi 4 MW, në kategorin e dytë të rrezikshmeris nga zjarri,
- * Stacioni i pompave Janosh, në kategorin e tretë të rrezikshmeris nga zjarri,
- * Stacioni i pampave në Rahovec, në kategorin e tretë të rrezikshmeris nga zjarri,
- * Depoja në Lug Bunar, në kategorin e tretë të rrezikshmeris nga zjarri,
- * Objektet për rrethë pendes, në kategorin e katërt të rrezikshmeris nga zjarri,dhe
- * Ndërtesa e administrates, në kategorin e katërt të rrezikshmeris nga zjarri,
- * Ndërtesa e NJP. në Rahovec, në kategorin e katërt të rrezikshmeris nga zjarri, dhe

* Ndërtesa e NJP. në Prizren, në kategorin e katër të rrezikshmëris nga zjarri.

Në bazë të caktimit të objekteve të kategorizimit të rrezikshmeris nga zjarri, caktohen organizimet përkatëse të mbrojtjes nga zjarri.

1. Referenti- punëtori në punët e mbrojtjes nga zjarri

Neni 25.

Referenti- punëtori (në tekstin e mëtejme –referenti i mbrojtjes nga zjarri), në kryerjen e punëve ka këto obligime:

- zbaton masat preventive të mbrojtjes nga zjarri të vërtetuara me ligjin dhe me rregullat tjera, me këtë rregullore dhe akte të përgjithshme normative,

- rregullisht kontrollon funksionimin e paisjeve automatike për lajmërimin e zjarrit dhe menjëher ndërmerr masat me qëllim të pruarjes së të njejtave në gjendje të rregulltë.

- vërteton numrin dhe vendosjen e aparateve në vende të tyre për fikjen e zjarrit, hidrantve dhe mjeteve tjera dhe kontrollon rregullshmerin e tyre dhe ndërmerr masat e duhura për ndrrimin e tyre, servisimin e tyre e tjera,

- merrë pjesë në pregaditjen dhe propozon në përpilimin e akteve të përgjithshme të mbrojtjes nga zjarri, dhe pas miratimit zbaton të gjitha masat të cilat janë në rrethin e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri,

- kontrollon zbatimin e konstatuar të masave të urdhëruar të mbrojtjes nga zjarri,

- në rast të shperthimit nga zjarrit, pësonalisht merrë pjesë në konstatimin e shkakut të zjarrit,

- rregullisht e njofton udhëheqësin me të gjitha paraqitjet, ndryshimet dhe problemet nga lamia e mbrojtjes nga zjarri dhe propozon në marrjen e masave konkrete,

- përcjell literaturën nga lamia e mbrojtjes nga zjarri, si dhe mjetet teknike nga kjo lami, në bazë të saj, propozon dhe ndërmerr masa t e duhura për përparimin e mbrojtjes nga zjarri, si dhe përdorimi i tyre në mënyrë efikase,

- propozon dhe kontrollon zbatimin e masave normative të mbrojtjes nga zjarri me rastin adaptimit, rekonstruimit dhe servisimit të paisjeve të cilat kryhen në objekt,

- bënë evidentimin e duhur nga lamia e mbrojtjes nga zjarri,

- në kryerjen e obligimeve nga paragrafi më i lartë, referenti i mbrojtjes nga zjarri, është i autorizuar:

* që të bëjë kontrollin e zbatimit të konstatuar apo të urdhëruar të masave të mbrojtjes nga zjarri,

* në rast konstatimit të mangësisë dhe të parregullsisë, për të cilat egziston rreziku permanent të shpërthimit të zjarrit urdhëron udhëheqësin e njësis punuese, në të cilën është konstatuar magnesia në punë apo direkt te punëtori, menjëher të largohen parregullsit ose të ndërprerjes së punës,

* të largon puntorin nga shërbimi i punëve dhe detyrave, nëse konstaton se është nën ndikimin e alkoholit, narkotikës, dhe të ngjajshme, apo në mënyrë tjetër i pa aftë të kryej detyra.

2. Punëtoret në punët e mbrojtjes nga zjarri – zjarrfiksit.

Neni 26.

Punëtoret në punët dhe detyrat e mbrojtjes nga zjarri, kanë këto obligime:

- gjatë kohës së kujdestaris, e në bazë të caktimit të orarit të shërbimit kryen punët dhe detyrat e mbrojtjes nga zjarri, në bazë të Ligjit përkatës dhe rregullave tjera, urdhëresave të kësaj Rregullore dhe akteve të përgjithshme nga kjo lami dhe vrejtjeve të udhëheqësit të këtij shërbimi,

-gjatë kohës së kujdestaris, shiqon dhe mbikqyr objektet, hapsirat, paisjet dhe instalimet e posaqrisht vendet ku egziston rreziku më i shtuar i shpërthimit të zjarrit dhe me vrejtjet e konstatuara të vendeve potenciale të shkaktuesve të zjarrit, menjëher e njofton udhëheqësin e drejtëpëdrejt dhe njëherit i ndërmerr të gjitha masat e duhura me qëllim të pengimit të shkaktimit të fatkeqsisive të padëshirueshme,

- gjatë kontrollimit të objekteve të prodhimit dhe të hapsirave tjera kontrollon rregullshmerin e paisjeve për fikjen e zjarrit dhe vendosjen e tyre në vendet e parapara dhe me rastin e mangësis e njofton udhëheqësin e drejtëpëdrejt dhe ndërmerr masat e duhura,

- tërheqë vrejtjet punëtorve në objekte për nevoja që të përmbahën masave të parapara të mbrojtjes nga zjarri. Në rastë që vëren se ata me veprime të tyre nuk përmbahen masave të rregulluara të mbrojtjes nga zjarri, edhe përkundër vrejtjes, menjëher njofton udhëheqsin e tij.

- të njoftohet dhe aftësohet me të gjitha masat e mbrojtjes nga zjarri, të konstatuar me planin e mbrojtjes nga zjarri, për objektet në të cilët bëhet kujdestaria zjarrfikse dhe obligimet tjera të caktuara me Ligj, me këtë Rregullore me akte të përgjithshme normative,

- në momentin e marrjes së kujdestaris- detyrës, punëtori-zjarrfikësi duhet me qenë i aftë me aftësin psiko-fizike për kryerjen e detyrave të punëve, në të kundërtën duhet të largohet në marrjen e detyres.

VI.DETYRAT DHE PËRGJEGJSIT E PUNËTORVE UDHËHEQËS DHE PUNËTORVE TJERË NË ZBATIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI

1.Menagjeri i K.R.U. Hidrosistemi “Radoniqi” në Gjakovë.

Neni 27.

Menagjeri i Kompanis, si organ udhëheqës, në pajtim me Ligjin dhe akte tjera normative i kryen punët dhe detyrat e punës nga lamia e mbrojtjes nga zjarri, siq vijon:

- është përgjegjes për organizimin e mbrojtjes nga zjarri në Ndërmarrje, zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri e posaqrishtë për zbatimin e normativave të urdhëruara të mbrojtjes nga zjarri në Ndërmarrje,
- në raste kur vrehen ose konstatohën shkelje apo mangësi, është përgjegjës që menjëher të merr masa për evitimin e vrejtjeve,
- i studjon dhe i propozon masat, me të cilat sigurohet mbrojtja nga zjarri,
- e kryen kontrollen e përgjithshme në ndërmarrjen e masave nga zjarri,
- organizon që paisjet dhe mjetet për fikjen e zjarrit, të jenë gjithmonë në gjendje të rregulltë dhe me to të disponohet me kujdes,
- sipas nevojës, e më së paku një herë në vit, të diskutohet në lidhje me mbrojtjen nga zjarri,
- e ndërpre punën në objekte të caktuara ose në vende të punës ku egziston rreziku nga zjarri dhe eksplodimi,
- përkohsisht e sistemon punëtorin në vende tjera të punës kur egziston nevoja që të pengohet zjarri,
- e cakton punën përtej orarit të punës, kur kjo është e nevojshme që të largohën rreziqet nga dëmi i zjarrit dhe eksplodimi,
- të largoj punëtorin nga punët dhe detyrat e punës, nëse është gjetur në lëndimin e rëndë të detyrave të punës nga mbrojtja nga zjarri, me të cilat e rrezikon sigurin e punëtorve dhe të pasurisë, ose nëse mund të supozohet që kërcnohet dëmi i madhë,
- kryen edhe detyra tjera nga lamia e mbrojtjes nga zjarri.

2. Punëtorët.

Neni 28.

Sejcili punëtor ka këto punë dhe detyra të mbrojtjes nga zjarri:

- të punoj në punët dhe detyrat e punës në të cilat janë plotësuar të gjitha kushtet për punë të sigurt nga pikpamja e mbrojtjes nga zjarri,
- të marrë pjesë në zbatimin e mbrojtjes nga zjarri,
- të rrefuzoi punën në punët dhe detyrat e punës me rrezik nga zjarri dhe eksplodimi, kur kërcnohet rrezik për jetë për shkak të mangësisë së masave të duhura mbrojtëse,
- të kërkoj nga udhëheqësit që ta njoftoi me rreziqet nga zjarri dhe eksplodimet në punët dhe detyrat e punës, si dhe ta njoftoi dhe ta aftësoi me masat e duhura të mbrojtjes nga zjarri dhe eksplodimi,
- të shiqoj aktet, të cilat rregullojnë lirin e mbrojtjes nga zjarri,
- të lajmëroj udhëheqësin për çdo shkak, i cili mund të shkaktojë zjarrin,
- i realizon edhe të drejtat tjera në pajtim me Ligjin dhe akte normative.

Neni 29.

Sejçili punëtor i ka obligimet e mbrojtjes nga zjarri ndaj ndërmarrjes, punëtorve tjerë dhe mjeteve të punës.

Që të mund të përgjigjet obligimeve të tij nga paragrafi 1. të këtij neni, duhet të përmbahet rregullave të mbrojtjes nga zjarri, siq vijon:

- të marrë pjesë në fikjen e zjarrit dhe të pengojë krijimin e dëmeve nga zjarri dhe eksplodimi,
- të kryej punët dhe detyrat e punës së tij, rrespektivisht çdo punë në mënyrë që mos të shkaktojë zjarrë,
- të zbatoj vendimet, urdhëresat dhe instrukcionet të mbrojtjes nga zjarri, të cilat i merr nga udhëheqësit e autorizuar, që ata i miratojnë në bazë të dipozitave, në kuadër të autorizimeve të tyre,
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri,
- të përmbahen shenjave, vërtetësive dhe udhëzimeve të mbrojtjes nga zjarri, të cilat janë të vendosura në vende të punës dhe në ambientin e punës,
- të marrë pjesë në aftësimin e organizuar të mbrojtjes nga zjarri,
- të lajmërojë personin e autorizuar për çdo shkak të dyshimt, i cili mund të shkaktojë zjarrin,
- të ia tërhejë vërtetjen çdo punëtori në lëshimin, për shkak të të cilit mund të shkaktohet zjarri apo eksplodimi,

- ti ruaj me kujdes, të sillet ndaj paisjeve dhe mjeteve për fikjen e zjarrit si ndaj shenjave të vrejtjeve dhe ndalesave,

-të merrë pjesë në ushtrime nga zjarri në Ndërmarrje

- të punoj edhe më gjatë se orari i punës në raste për shkak të ndërmarrjes së masave preventive, duhet të kryej edhe aktivitete tjera të urdhëruara nga eprori i drejtpërdrejt.

VII. PËRGJEGJSIT MATERJALE DHE TJERA TË PUNËTORIT PËR SHKAK TË MOSPËRRMBAJTJES SË MASAVE TË CAKTUARA TË MBROJTJES NGA ZJARRI

Neni 30.

Punëtori përgjigjet nëse me fajin e tij nuk i kryen ose në mënyrë tjetër nuk i zbaton obligimet e mbrojtjes nga zjarri, masa të cilat janë të caktuara me Ligj, me këtë Rregullore dhe me akte të organit kompetent.

Neni 31.

Procedura për caktimin e përgjegjsive për lëndimin e obligimeve nga mbrojtja nga zjarri, udhëheqja e procedurës dhe shqiptimi i masave bëhet sipas dispozitave ligjore dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 32.

Punëtori, i cili në punë, respektivisht në lidhje me punën me fajin ose me pakujdesi të rënda shkakton dëm material Kompanisë është i obliguar që këtë ta kompenzojë.

Dëmin material të krijuar për shkak të zjarrit ose eksplodimit, e cakton komisioni prej tre anëtarëve, të cilët i emron Menagjeri i Kompanisë.

Neni 33.

Lëndimet e punës nga mbrojtja nga zjarri mund të jenë të lehta dhe të rënda.

Gjatë shqiptimit të masave për caktimin e përgjegjshëm të punëtorit për lëndimin e obligimeve nga mbrojtja nga zjarri, duhet të mirren parasysh këto rrethana:

- shkalla e pregaditjes profesionale, kualifikimi i punëtorit dhe se a është në dijeni për rregullat të mbrojtjes nga zjarri,

- përvoja e punës, dhe se a ka punuar më heret në punët dhe detyrat e punës së këtij lloji,

- puna e mëhershme dhe sjellja e punëtorit,

- lartësija e dëmit dhe ndikimi në punë e mëtejshme.

Neni 34

Për shkak të lendimit të obligimeve nga mbrojtja nga zjarri, punëtorit mund ti shqiptohet masa e caktuar me Ligj dhe me akte normative të K.R.U. HS. "Radoniqi" në Gjakovë.

Punëtorit mundë ti pushoj marrëdhënja e punës nëse nuk i kryen detyrat dhe obligimet nga mbrojtja nga zjarri, rëndë i lendon interesat e përbashkta të punëtorve dhe të K.R.U. "Radoniqi" në Gjakovë, rrespektivisht bënë lendimin e rëndë të obligimeve të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 34.

Lendime të lehta nga mbrojtja nga zjarri janë:

- mos lajmërimi i personave të autorizuar ose Menagjerin e Kompanis, të cilat mund të shkaktojnë zjarrin,
- mos njoftimi i punëtorve të tjerë mbi lëshimet e bërë nga mbrojtja nga zjarri,
- mos marrja pjesë në ushtrimet nga zjarri,

Lëndimet e rënda nga mbrojtja nga zjarri, janë:

- mos marrja pjesë në zbatimin e masave të caktuara nga zjarri në Kompani,
- kryerja e obligimeve në mënyrë të pakujdesshme dhe të vetëdijshme në lidhje me mbrojtjen nga zjarri,
- sjellja e pakujdesshme dhe e padijshme ndaj paisjeve dhe mjeteve për fikjen e zjarrit,
- refuzimi të sistemohet përkohsisht në punë të tjera kur këtë e kërkojnë kushtet e mbrojtjes nga zjarri,
- refuzimi i paarsyeshëm të punoj më tepër se orari i plotë i punës me rastin e krijimit dhe të fikjes së zjarrit ose me rastin e shpëtimit të pasurive,
- mos marrja pjesë në fikjen e zjarrit dhe të pengimit të dëmit të shkaktuar,
- refuzimi i paarsyeshëm i zbatimit të vendimeve, udhëzimeve dhe instruksioneve nga mbrojtja nga zjarri, të cilat i bëjnë strukturat menagjuese të autorizuar,
- shkelja e dispozitave dhe rregullave nga mbrojtja nga zjarri në punët dhe detyrat e punës me rrezik të shtuar nga zjarri,

- mos lajmërimi i përsoneve të autorizuar për shkaqe, të cilat mund të shkaktrojnë zjarrë, nëse për këtë shkak janë shkaktuar pasoja të rënda për punëtozet dhe për pasurin.

VIII. VEPRIMI ME RASTIN E ZJARRIT

Neni 35.

Sejcili punzor në Kompani është i obliguar që menjëher me vështrimin e shkaktimit të zjarrit, të lajmëroj punëtozet për zjarrin dhe me paraqitjet tjera në lidhje me zjarrin, menjëher merrë masa për fikjen e zjarrit nëse këtë mund ta bëjë pa rrezik për veti dhe punëtozet tjerë.

Krahas masave të caktuara për fikjen e zjarrit, duhet të ndërmer masat gjegejse për shpëtimin e punëtozve dhe pasuris.

Nëse punzori nuk mund vetëm ta fikë zjarrin, është i obliguar që menjëher të thërras Njësin e zjarrëfiksve.

Punëtozët janë të obliguar të marrin pjesë në fikjen e zjarrit dhe shpëtimin e njerzve dhe të pasuris së rrezikuar gjerë sa të fiket zjarri, rrespektivishtë shpëtimi të kryhet.

IX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 36.

Kjo Rregulloze hyn në fuqi tetë (8) ditë pas shpalljes në tabelen e shpalljeve të kësaj Kompanije, e më parë me marrjen e pëlqimit nga ana e departamentit të preventives së zjarrit dhe hetimeve.

GJAKOVË,_____2001

**K.R.U. HIDROSISTEMI
"RADONIQI"**
